



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 3442 Prot.

Vau Dejës, me 20.06.2025

Lënda: Njoftim për mbledhjen e Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, neni 57 pika 2 germa c, ju njoftojmë se mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës zhvillohet ditën e Ejte me datë 26.06.2025, ora 14:00. Mbledhja do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Njësia Administrative Bushat.

Me këtë rend dite:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.05.2025 dhe 05.06.2025, si dhe informacion për VKB-të e marra në këto mbledhje.
- 2.Projekt vendim për miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Znj.Edona Ndue Molla.
- 3.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2025.
- 4.Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027 dhe numrin e punonjesve të Bashkisë Vau Dejës”.
- 5.Projekt vendim për miratimin e PBA 2026-2028, faza e parë për Bashkinë Vau Dejës.
- 6.Raport i monitorimit për periudhën Janar-Prill 2025 dhe vetëvlerësimi për situatën e gjendjes financiare Janar-Prill 2025.
- 7.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes të shtetasit Pjetër Mirash Gjoni i dëmtuar nga zjarri me datë 16.05.2025, banorë i Bashkisë Vau Dejës.
- 8.Projekt vendim për miratimin e rinovimit të kontratës së qirasë me nr.1460 prot. datë 16.03.2022, lidhur mes Bashkisë Vau Dejës dhe shoqërisë “ONE Albania sh.a” për sipërfaqen prej 150 m2 pjesë e pasurisë nr.663 Zk 2708 e llojit “Truall” në fshatin Mnelë Bashkia Vau Dejës.Fusha e përdorimit të pronës “ Për ushtrimin e veprimtarisë së antenave të transmetimit të telefonisë celulare të shoqërisë “ONE Albania sh.a”.
- 9.Projekt vendim për miratimin e subvencionit të qirasë dhe vlerën e përfitimit për znj.Matilda Terziu në programin e strehimit “ Subvencioni i qirasë në tregun e lirë”
- 10.Të ndryshme.

Komisionet e këshillit do mblidhen ditën e Mërkure, datë 25.06.2025 ora 09.00 pranë Nj.A Bushat.

1.Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Ligjore dhe Administrative.

2.Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe planifikimit të zhvillimit strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

4. Komisioni i bujqësisë, pyjeve, menaxhimit të ujërave, mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit.

5. Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj

